

URDHËR
Nr. 149, datë 22.8.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; si dhe Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024 , i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative me karakter të përgjithshëm në kompetencë të titullarit/komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe rregullores së institucionit të znj. Blerta Nerguti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 25.8.2025 deri më datë 29.8.2025.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONER PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
Besnik Dervishi